



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Z. Bajram Kosumi, Rektor, tani e tutje si UKZ,

dhe

Agjencia për Zhvillim Rajonal - Lindje, përfaqësuar nga znj. Valbona Tahiri, Drejtoreshë Ekzekutive, tani e tutje si AZhR-Lindje,

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

1. Rëndësia e memorandumit

Duke qenë se:

- Strategjia për zhvillimin e arsimit të Lartë në Kosovë (2005-2015) saktëson dhe kërkon nga të gjitha institucionet relevante shoqërore të vendit që të kontribuojnë dhe ndihmojnë arritjen e cilësisë në procesin e mësimin akademik, duke i ofruar kapacitetet e nevojshme për përgatitjen e specialistëve;
- Ligji për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L - 037 kërkon nga institucionet e arsimit të lartë universitar që programet e studimit dhe aktivitetet akademike t'i ndërlihdhin ngushtë me punë dhe aktivitete praktike në jetën shoqërore;
- Kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit "Kadri Zeka", në Gjilan dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal-Lindje siguron programe të përbashkëta bashkëpunimi në hulumtim, zhvillim dhe implementim të programeve specifike për rajonin ekonomik Lindje, si dhe aktiviteteve të tjera me interes të përbashkët.

2. Qëllimi i Marrëveshjes:

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të sipërsënuara.

Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithëmbarshtëm socio-ekonomik të rajonit ekonomik-Lindje të Kosovës.

Rekomandimet dhe ekspertiza profesionale janë të nevojshme veçmas në: idetë, projektet lokale dhe ndërkombëtare, pilot -projektet dhe programet e caktuara që kanë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë marrëveshje.

3. Forma e Bashkëpunimit

Palët u dakorduan që të:

1. Institucionalizohet bashkëpunimi reciprok dhe i ndërsjellë në sferën e ofrimit të ndihmës për ngritjen e kapaciteteve të studentëve të këtij universiteti dhe AZhR-Lindje;
2. Bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve lokale dhe ndërkombëtare me interes të përbashkët;
3. Shkëmbimi i eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve;
4. Zhvillimi i programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore, dhe projekte të tjera të cilat janë me interes të të dy institucioneve;
5. Organizimi i konferencave, trajnimeve, seminareve dhe bashkëpunime të tjera profesionale;
6. Për të zbatuar më mirë këtë marrëveshje, secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues, për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas formave të përcaktuara më lartë.

4. Baza ligjore

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit është e bazuar në terësi mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve, të cilat i kanë të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe në Ligjin Nr 04/L-57 për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare (OJQ).

5. Financat

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado pale, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

6. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve.

Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si në vijim:

- Mosmarrëveshjet eventuale palët do të përpiqen që t'i tejkalojnë me mirëkuptim;
- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;
- Marrëveshja mund të prishet nëse palët e argumentojnë se e njëjta nuk mund të funksionojë sipas frymës së saj;

7. Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje lidhet me kohë të caktuar prej gjashtëdhjetë muajve (60) duke filluar nga data 26/01/2018 deri me datë 25/01/2023, me mundësi të zgjatjes së afatit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet të dyja palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga njëra palë me paralajmërim prej së paku tre (3) muaj.

Marrëveshjet verbale për çështje të caktuara, gjithashtu nuk gjejnë mbështetje në këtë Marrëveshje dhe ato nuk do të merren parasysh.

7. Standardet

Të dyja palët janë të obliguara të përmbushin këtë Marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë.

8. Gjuha e kontratës

Kjo Marrëveshje do të përpilohet në gjuhën Shqipe.

9. Mospajtimet

Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.



10. Ligji i aplikueshëm

Palët respektojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, rregullat dhe kërkesat tjera të aplikueshme të autoriteteve përkatëse shtetërore.

11. Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale, për secilën palë nga dy.

Për UKZ:		Për AZhR Lindje:	
Emri:	Z. Bajram Kosumi	Emri:	Znj. Valbona Tahiri
Pozitat:	Rektor, UKZ	Pozita:	Drejtoreshë Ekzekutive, AZhR-Lindje
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data/ Vendi:	26 Janar 2018, Gjilan	Data/ Vendi:	26 Janar 2018, Gjilan
Vula:		Vula:	